

Informim koronavirusi për punonjësit në ekonomi shtëpiake (gjendja e 17 prillit 2020)

Hyrje

Pas krizës së shkaktuar nga koronavirusi, këtu mund t'i gjeni informatat që ne mund t'ju japim aktualisht, por ka të ngjarë të ndryshojnë shpejtë. Informatat azhurohen rregullisht në faqën tonë të internetit www.cheques-emploi.ch/informations_coronavirus/

Këshilli federal nuk ka dekretuar kufizimin e përgjithshëm të popullatës.

Punët shtëpiake mbesin të autorizuara.

Personat më të prekshëm/ më të rrezikuar janë:

- personat më të vjetër se 65 vjeçar,
- personat tashmë të sëmurë të cilët vuajnë nga patologjitë e poshtëshënuara, në veçanti :
 - tensioni i lartë
 - diabetit, sëmundjet kardiovaskulare
 - sëmundjet kronike të frymëmarrjes
 - dobësimi i imunitetit i shkaktuar nga një sëmundje ose nga ndonjë terapi
 - kanceri

Pyetjet më të shpeshta

1. Nëse punëdhënësi nuk dëshiron që ju të punoni ?

Punëdhënësi paguan pagën tuaj sikur të kishit ardhur në punë, si zakonisht, dhe nuk mund të kërkojë t'i merrni pushimet ose të zëvendësoni orët.

2. Nëse vendosni të mos shkoni në punë ?

Ju nuk keni të drejtë në pagën tuaj sepse është zgjidhja e juaj të hiqni dorë nga puna e juaj, përveç nëse punëdhënësi nuk i respekton rregullat e higjienës të destinuara për t'ju mbrojtur dhe nuk i ndërmer masat e nevojshme mbrojtëse, sipas kërkesës suaj të shprehur.

EPER Chèques-emploi/Per/7.2.2017

ENTRAIDE PROTESTANTE SUISSE

3. Nëse punëdhënësi i juaj është i sëmurë ose është një person më i rrezikuar ?

Punëdhënësi duhet t'ju paguajë pagën tuaj sikur të kishit shkuar në punë, si zakonisht.

4. Nëse ju jeni i sëmurë?

Rregullat e përgjithshme për pagimin e pagës suaj në rast të paaftësisë për punë zbatohen në të njëjtën mënyrë si për çdo sëmundje tjetër.

Punëdhënësi juaj ju paguan pagën sikur të kishit ardhur në punë, si zakonisht:

- në bazë të shkallës së Bernës nëse punëdhënësi nuk është regjistruar në sigurimin për humbje të fitimit në rast sëmundjeje, përkatësisht 3 javë gjatë vitit të parë të shërbimit, 1 muaj gjatë vitit të 2-të të shërbimit, 2 muaj nga viti i 3-të deri në vitin e 4-të të shërbimit, 3 muaj që nga viti i 5-të deri në vitin e 9-të të shërbimit, 4 muaj që nga viti i 10 e deri në të 14-in të shërbimit, etj.

ose

30 ditët e para të sëmundjes, atëherë nga dita e 31 e mungesës- mungesë e vërtetuar me një çertifikatë mjekësore- është siguri i humbjes së fitimit në rast të sëmundjes (PGM) që ndërhyt.

Për të gjitha sqarimet : shikoni në faqën tonë të internetit, në www.cheques-emploi.ch/questions-reponses/ « çka duhet bërë nëse punonjësi im është i sëmurë ».

5. Nëse fëmiju i juaj është i sëmurë?

Prindërit kanë të drejtë në pushim më së shumti në kohëzgjatje prej 3 ditësh, për t'u organizuar dhe paguhen sipas rregullave të njejta si në rast sëmundjeje.

- ➔ Për të gjitha sqarimet : shiko në faqën e internetit: www.cheques-emploi.ch/questions-reponses/ » Çka duhet bërë nëse punonjësi im duhet kujdesur për fëmijun e tij të sëmurë »

6. Nëse ju jeni një person i ashtuquajtur më i prekshëm/ më i rrezikuar?

Punëdhënësit tuaj janë të obliguar të marrin masa organizative dhe teknike, të afta për të garantuar respektimin e rekomandimeve të Konfederatës për çështje të higjienës dhe distancës sociale.

Nëse nuk ju mundësohet t'i përmbushni detyrimet e juaja profesionale në mënyrën e përcaktuar, punëdhënësi i juaj është i obliguar t'ju lejoj një pushim me pagesë.

Ju mund t'a paraqitni situatën tuaj, të ndjeshmërisë më të madhe/ si person më i rrezikuar, me një deklaratë personale.

Punëdhënësi juaj mund të kërkojë një çertifikat mjekësore.

7. A duhet të paraqitni një certifikat ose një vërtetim mjekësor nëse jeni person më i cënueshëm/ më i rrezikuar ose nëse jeni i sëmurë?

Obligimi për të paraqitur një certifikat mjekësore duhet të jetë i lehtësuar, por keni kujdes, në rast të kohëzgjatjes më të madhe të sëmundjes, në certifikat duhet të figurojë data e fillimit të paaftësisë për punë, ngase ajo datë do të mirret parasysh për kërkimin e pagesës në sigurimin për humbjen e fitimit për shkak të sëmundjes (PGM).

Vetëm certifikatat mjekësore që dëshmojnë për paaftësi në punë, japin të drejtën e përfitimeve ditore të sigurimit të humbjes së fitimit për shkak të sëmundjes që nga dita e 31. Certifikatat mjekësore që tregojnë se punonjësi është një person në rrezik nuk e hapin asnjë të drejtë në përfitime ditore të sigurimit shëndetësor për humbje të fitimit.

8. Nëse fëmiju i punëdhënësit është i sëmurë?

Punëdhënësi paguan pagën e juaj sikur të kishit ardhur në punë normalisht. Nuk mund të kërkohet nga ju t'i merrni pushimet ose t'i zëvendësoni orët

9. A mundet punëdhënësi të kërkojë papunësi të pjesshme për punët në ekonominë shtëpiake?

Megenëse situata pandemike është plotësisht e re dhe e jashtëzakonshme, Chèques-emploi ftoi autoritetet në njohjen e pozicionimit të tyre lidhur me mundësin e marrjes përsipër të pagave të punonjësve në ekonominë shtëpiake me pagimin e papunësisë së pjesshme RHT (pagesë në rast të reduktimit të orarit të punës).

Fatkeqësisht, në konferencën për shtyp të 8 prillit 2020, Këshilli federal njoftoi se punëdhënësit e personelit shtëpiak nuk do të kenë të drejtë në papunësi të pjesshme. Ata konsiderojnë se një kërkesë e tillë për reduktim të orarit të punës për këtë kategori të punonjësve është shumë komplekse : <https://www.admin.ch/gov/fr/accueil.html>

10. Nëse jeni në karantinë?

Personat e vendosur në karantinë, të cilët duhet të ndërpresin aktivitetin e tyre fitues, kanë të drejtë në më së shumti 10 paga të paguara nga APG (paga nga humbja e fitimit)

Punëdhënësi është ai i cili merr këtë fitim, nëse ai vazhdon t'ju paguaj pagën.

Ky përfitim do të jetë në shumën prej 80% të të ardhurave mesatare bruto të aktivitetit fitues të marrur në 3 muajt e fundit para fillimit të së drejtës.

Ky përfitim është plotësues, prandaj nëse merrni ndonjë përfitim nga ndonjë sigurim tjetër social (p.sh. nga papunësia) ose privat (p.sh. sigurim shëndetësor për humbje të fitimit), ju nuk mund të keni çasje në këtë të drejtë.

Formulari që duhet plotësuar në faqën : https://form.ahv-iv.ch/orbeon/fr/AHV-IV/318_758_vers_20-03-2020/new

PDF : https://www.ahv-iv.ch/Portals/0/Documents/Formulare/EO-MSE/318.758.vers.25-03-2020_F_web.pdf?ver=2020-03-25-120600-513

Arka në të cilën është regjistruar Chèques-emploi është Caisse cantonale vaudoise de compensation AVS (22) et le N° d'affilié est le 1500 799-60.

11. Nëse duhet kujdesur për fëmijët tuaj pas mbylljes së shkollave ?

Prindërit e fëmijëve nën moshën 12 vjeçarë të cilët duhet ndërprerë veprimtarinë e tyre fituese për shkak se kujdesi për fëmijët nga pala e tretë nuk mund të sigurohet (mbyllja e shkollave, e çerdheve ose kujdesi i siguar nga një person në rrezik) kanë të drejtë në përfitime ditore të paguara nga APG.

E drejta merr fund kur të gjendet një zgjidhje kujdestarie ose kur hiqen masat e destinuara për të luftuar kundër koronavirusit.

Përfitimi arrin shumën 80% e të të ardhurave mesatare bruto të aktivitetit fitimprurës të realizuar 3 muajt e fundit para fillimit të së drejtës. Vetëm njëri prind ka të drejtë në këtë përfitim.

Përfitimi është plotësues. Nëse, përfituesi tashmë merr përfitime nga një tjetër sigurim shoqëror ose privat, nuk mund të pretendoj në këtë përfitim.

Përfitimi i paguhet punëdhënësit, nëse ai vazhdon të paguaj pagën.

Udhëzimet për të plotësuar formularin :

https://www.caisseavsvaud.ch/fileadmin/user_upload/doc_anleitung_corona_fr.pdf

Formulari që duhet plotësuar : https://form.ahv-iv.ch/orbeon/fr/AHV-IV/318_758_vers_20-03-2020/new

PDF : https://www.ahv-iv.ch/Portals/0/Documents/Formulare/EO-MSE/318.758.vers.25-03-2020_F_web.pdf?ver=2020-03-25-120600-513

dërgone në këtë adresë : apgcovid@avs22.vd.ch

Arka në të cilën është regjistruar Chèques-emploi është Caisse cantonale vaudoise de compensation AVS (22) et le N° d'affilié est le 1500 799-60.

Informata të përgjithshme

Rekomandimi për respektimin e masave të parapara, është lëshuar nga autoritetet. Ju mund të vazhdoni të informoheni nëpërmes të faqës së internetit të kantonit Vaud, në www.vd.ch dhe të Konfederatës <https://www.admin.ch>.

Informatat e mësipërme janë vendime të pushtetit publik dhe nuk e obligojnë në asnjë mënyrë EPER-in. Meqenëse situata po ndryshon prej javës në javë edhe informatat ndërrojnë në shpejtësi.